



Mali i Zi
Komisioni për Parandalimin e
Konfliktit të Interesit



Republika e Kosovës
Agjencia kundër Korrupsionit

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

Neni 1.

Komisioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nga Mali i Zi dhe Agjencia Kundër Korrupsionit nga Kosova kanë rënë dakord që të bashkëpunojnë nëfushat që lidhen me parandalimin e korrupsionit dhe parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë.

Neni 2.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është shkëmbimi injohurive dhe përvojave në zbatimin e standardeve ndërkombëtare ligjore dhe rregulloreve të brendshme të tyre në fushën e shënuar në pikën 1 të këtij memorandum, në përputhje me konkluzionin e Iniciativës Rajonale Anti-korrupsion (IRA) për Evropën Juglindore.

Neni 3.

Bashkëpunimi do të bëhet përmes projekteve studimore, trajnimeve të përbashkëta, organizimin e punëtorive, seminareve dhe konferencave, edukimin e subjekteve të mundshme në konflikt të interesit dhe korrupsionit, përmirësimin e qasjes në informata që janë relevante për parandalimin e konfliktit të interesave, forcimin e bashkëpunimit rajonal me mekanizmat e ngjashëm.

Neni 4.

Me qëllim të zbatimit sa më efektiv të projektit dhe arritjen e objektivit të përcaktuar në këtë memorandum, Komisioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nga Mali i Zi dhe Agjencia Kundër Korrupsionit nga Kosova do të konsultohen dhe shkëmbejnë informata relevante që në frymën bashkëpunuese ta bëjnë përmirësimin dhe reformën legislative, që trajton zonën e konfliktit të interesit.


Miratuar më Podgorica 27. 02. 2014, në dy kopje në gjuhët: malazeze, shqipe dhe angleze.

Komisioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit

Agjencia Kundër korrupsionit

Kryetar

PhD Slobodan LEKOVIC



Drejtor

Hasan PRETENI

